



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 24.11.2018

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Vizitë pune e Komisionit në Kalanë e Gjirokastrës.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Vilma Bello, Almira Xhembulla, Adelina Rista, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Besnik Baraj (deputet zëvendësues) Anduel Xhindi (deputet zëvendësues) dhe Bledar Çuçi.

Mungojnë:

Musa Ulqini, Fatmir Velaj, Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Nora Malaj dhe Kejdi Mehmetaj.

Prezent:

Ledion Lako - drejtor i Përgjithshëm, Ministria e Kulturës,

Vasil Polo - drejtor i komanduar, përfaqësues nga Zyra e Ministrisë së Kulturës Gjirokastrë,

Jani Duri - shef sektori, Zyra Rajonale për Kulturën Gjirokastrë,

Ambasadori Bernd Borchard - Kryetar i Prezencë së OSBE-së.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

Ju falënderoj të gjithëve për mbrëmë, darka ishte e mirë, por edhe ne ia kaluam shumë mirë me njëri-tjetrin. Gjithashtu, dua të falënderoj edhe Faten që na bëri disa fotografi, të cilat duhet t'i mbajmë me shumë kujdes te grupi ynë i kulturës.

Sot vazhdon vizita, të cilën e kishim planifikuar që dje, që lidhet me mënyrën se si është ndjekur trendi turistik në dy shtet tona të trashëgimisë kulturore, atë të Butrintit dhe të Gjirokastrës. Pra, për të parë numrin e vizitorëve që ka pasur shteti, sasinë e të ardhurave që ka realizuar, si i kanë përdorur të ardhurat dytësore dhe çfarë nevojash kanë për të shtuar bashkëpunimin me bashkinë dhe organizatat ndërkombëtare, çfarë propozimesh kanë ata për komisionin që t'i adresojmë si çështje ligjore, si dhe çështje të tjera që lidhen me menaxhimin më të mirë të saj.

Para se të vazhdojmë me prezantimin, të cilin do të na e bëjë drejtori i muzeut, si dhe drejtori i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës që merret me çështjen e trashëgimisë kulturore, do të doja të pyesja zotin Ylli nëse e kemi kuorumin apo jo?

Fidel Ylli – Po, kuorumi është i plotë. Jemi 10 anëtarë të komisionit që kemi marrë rrugën nga Tirana me mbështetjen e OSBE-së dhe të ambasadorit të saj në Tiranë. Ndiej keqardhje për opozitën, e cila në vend që të vijë dhe të shohë këto mrekulli të vendit tonë dhe t'i mbështesë këto projekte, përsëri vazhdon bojkotin.

Milva Ekonomi – Faleminderit!

Ledion, a mund të na thuash disa gjëra për shtetin?

Por para se ti të marrësh fjalën, dua të falënderoj dy persona. Kur Mira po bënte gati kalendarin e udhëtimit, u ul dhe foli me dy deputetë të zonës, zotin Çuçi dhe zotin Golemi për idenë që na dhanë! Ky falënderim është jo vetëm për pjesën formale të vizitës, por edhe për pjesën informale, se çfarë gjërash të reja duhet të shihnim në qytetin e Gjirokastrës dhe jo vetëm në kala, të cilat kanë ardhur si rezultat i mirëqeverisjes dhe i mirëmenaxhimit të fondeve.

Ju falënderoj për propozimet që na bëtë!

Faleminderit Mira që i more në konsideratë dhe i vure në axhendë!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ledion Lako – Në radhë të parë, falënderoj Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, i cili në bashkëpunim me OSBE-në ka krijuar mundësinë e këtyre aktivitete, siç ishte ai i djeshmi në Butrint dhe sot në Gjirokastrë për njohjen e këtyre siteve, si dhe të problematikave dhe si mund t'i përmirësojmë ato për vitin që vjen.

Do t'ju flas në përgjithësi për arritjet e këtij viti, sa i takon numrit të vizitorëve, i cili ka qenë shumë i madh në krahasim me vitin e kaluar. Sipas statistikave, analiza krahasuese e të dhënave statistikore për periudhën janar-tetor 2017 dhe janar-tetor 2018 dëshmon se trendi i vizitueshmërisë ka shënuar rritje. Periudha janar-tetor 2018 shënon 334 552 vizitorë në total më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2017, si dhe 429 mijë vizitorë në total më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2016.

Pra, kemi një rritje me 54% të numrit total të vizitorëve në të gjithë vendin në parqe arkeologjike, muze dhe monumente kulture. Totali i të ardhurave në lekë nga vizitorët me biletë në muze, parqe dhe monumente për periudhën janar-tetor 2018 është 190 221 000 lekë të reja, pra rreth 1 milion e gjysmë euro në total, ku edhe këtu shihet një trend shumë i lartë krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2017 po për të njëjtën periudhë kishim 136 441 000 mijë lekë. Kjo që sapo ju thashë ishte thjesht për t'u njohur me numrin total të vizitorëve në të gjithë vendin.

Po dal konkretisht te kalaja e Gjirokastrës. Në kalanë e Gjirokastrës për periudhën janar-tetor 2018 kemi 109 353 vizitorë. Pra, një numër shumë i madh krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur ky numër ka qenë 72 651, dhe po ta krahasojmë me rritjen e të ardhurave, kemi 28% rritje të të ardhurave për këtë 10-mujor.

Milva Ekonomi - Po çmimi i biletës a ka ndryshuar?

Ledion Lako – Çmimi i biletës është i njëjtë, 200 lekë për person. Risi kanë qenë biletat elektronike, nëpërmjet të cilave ka një kontroll më të mirë nga ana e menaxhimit të *site-it*, por kjo ka ndihmuar edhe në rritjen e numrit të vizitorëve.

Gjithashtu, kemi parkun arkeologjik në Antigone dhe këtu ka një rritje me 63% të të ardhurave në krahasim me vitin e kaluar. Sot numri i vizitorëve është 1125, vitin e kaluar ka qenë 883.

Në parkun e Gjirokastrës janë bërë shumë investime. Unë do të rendis disa nga investimet që ka bërë Ministria e Kulturës në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare dhe lokale: kisha e Shën Mërisë në Peshkëpi të Sipërme; kisha e Shën Apostujve në Zagori, ura e Gollorcës, 4 kilometra në juglindje të Gjirokastrës, dhe restaurimi i urës së Nivanit në Zagori. Puna më e

madhe që është bërë nga DRKK-ja e Gjirokastrës ka të bëjë me mirëmbajtjen. DRKK-ja e Gjirokastrës punon çdo ditë për të mirëmbajtur këtë pasuri kulturore që ndodhet në qendër të qytetit.

Gjatë vitit 2018 janë kryer punime mirëmbajtjeje në të gjithë vendin, janë restauruar 170 monumente kulture, nga të cilat 33 banesa, 44 objekte kulti dhe 93 monumente të qendrave historike. Më saktësisht për këto do të flasë drejtori.

Gjithashtu, është restauruar kulla e sahatit në Gjirokastrë, pazari i Gjirokastrës. Këtu është për t'u vlerësuar bashkëpunimi që ka pasur Ministria e Kulturës me ADP-në, është vendosur biletari elektronike në destinacionet më të rëndësishme dhe ky projekt po vazhdon në 10 site, si: në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastrioti" në Krujë, në Muzeun Kombëtar Etnografik në Krujë, në Parkun Kombëtar Arkeologjik në Apolloni, në kalanë në Tiranë, në Muzeun Kombëtar Historiografik "Onufri" në Berat, në Parkun Kombëtar Arkeologjik në Shkodër dhe në kalanë e Gjirokastrës.

Milva Ekonomi- Meqenëse keni vënë biletari dixhitale, a e keni bërë *smart*?

Ledion Lako- Për momentin jemi duke punuar me një kontratë me ADP-në, ku mund të gjenden bileta *online*. Kjo do të ndikojë, por për momentin vizitorët vijnë në site dhe pajisen me bileta. Nuk e kemi këtë teknologji.

Gjithashtu, bashkëpunim shumë i frytshëm ka qenë me IPA-n, ku bëhet fjalë për restaurimin e monumenteve të kulturës të kultit islam, si, për shembull, në Gjirokastrë kemi xhaminë, e cila po restaurohet. CHV-ja na ka ndihmuar shumë për trajnimin e të rinjve dhe specialistëve në fushën e trashëgimisë.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Fondin e Zhvillimit të Rajoneve është bërë i mundur restaurimi i "Fjetja e Shën Mërisë" në Gjirokastrë, rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimi i kalldrëmeve në pazarin e Gjirokastrës.

Kjo është në makro një panoramë e asaj që ka bërë Ministria e Kulturës për restaurimin e trashëgimisë kulturore.

Milva Ekonomi- Kur vijnë vizitorët te ju, i bëni biletat me *fanter*, pra që vizitori të shohë edhe pazarin apo është vetëm për këtu?

Vasil Polo – Është vetëm për këtu. Biletaria kryesore është për kalanë, sepse muzeu është në administrim të bashkisë.

Milva Ekonomi- Pra, kjo e ardhur nuk është juaja?

Vasil Polo - Jo, është e bashkisë.

Milva Ekonomi- Kjo ku derdhet?

Vasil Polo - 10% derdhet në buxhet dhe 90% i kalojnë institucionit, pra krijuesit të të ardhurave, i cili ripërdoret nga Ministria e Kulturës, duke u rialokuar në fondet e vitit në vazhdim.

Milva Ekonomi – Pra, kjo është për të gjithë...

Ledion Lako - Jo, sepse ne atë kërkuam në komision, që 90 % të derdhet në buxhetin e shtetit dhe pastaj Ministria e Financave ka tavane ku na vendos shifra, që janë shumë të vogla. Ne këtë po kërkojmë, që 90% të kalojë në thesarin e çdo institucioni varësie që ka Ministria e Kulturës, në mënyrë që ato të ardhura të përdoren për monumentin ose për kalanë, në rastin konkret.

Jani Duri - Në radhë të parë, falënderoj të gjithë njerëzit e nderuar që më nderuan me pjesëmarrjen, veçanërisht ambasadorin e OSBE-së në Shqipëri dhe gjithë deputetët e nderuar të Shqipërisë!

Unë përfaqësoj drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Gjirokastrë, e cila është një ndërmarrje e vogël që merret me ruajtjen e vlerave të monumenteve. Dua të flas për aktivitetin tonë në lidhje me mirëmbajtjen e monumenteve në Gjirokastrë.

Ne kemi marrë përsipër dhe deri tani kemi rikonstruktuar një pjesë të mirë, rreth 30 objekte, të cilat i zëmë në fazën para se të fillojë shkatërrimi i monumentit, në pjesën kryesore të qytetit dhe atë pjesë që është më e vizitueshme, në bazë të varësive dhe vlerave që ka çdo objekt. Me mundësitë tona kemi rikonstruktuar rreth 30-40 objekte, të cilat do të donim t'i shtonim edhe më tepër këtë vit, për të arritur atë shprehjen: “Një gur i vënë sot, do të jetë një çati pas një viti”, sepse, po të shikoni, ndërtesat në Gjirokastrë janë pothuajse të gjitha me çati, të cilat me kalimin e viteve, degradimi i një kolone apo një trari, mund të prishë të gjithë çatinë.

Gjatë punës sonë kemi bashkëpunuar me disa organizata, për shembull, parkun e topave, i cili ishte një bashkëpunim i frytshëm i DRKK-së së Gjirokastrës me Korpusin e Paqes, i cili na ndihmoi si me specialistë, edhe me një pjesë të fondit për krijimin e këtij parku shumë të bukur.

Kemi bashkëpunuar gjatë kësaj kohe edhe me CVB-në, një fondacion, i cili ka investuar goxha në Gjirokastrë. Vlen të përmendet se kemi bashkëpunuar me ta, duke i dhënë logjistikën dhe specialistët tanë për rikonstruksionet e ndryshme që kanë bërë, gjithashtu ata na kanë ndihmuar me tabelat e bukura treguese që kanë vendosur në qytet. Ne kemi bërë pjesën tonë dhe ata kanë krijuar. Kjo është diçka shumë e bukur. Ata janë marrë, gjithashtu, me vendosjen e disa hidrateve,

të cilët janë shumë të domosdoshëm në Gjirokastrë dhe do të vazhdojë bashkëpunimi për t'i vendosur në të gjithë qytetin.

Në Gjirokastrë ka pasur disa vjedhje të monumenteve të papërsëritshme dhe nuk kemi ç'të bëjmë për gjërat që kanë humbur.

Me pushtetin vendor kemi bashkëpunim të frytshëm; gjithashtu, ne u kemi ofruar mjetet tona logjistike dhe eksperiencën tonë për hartimin e projekteve për mbarëvajtjen e tyre. Kemi bashkëpunuar për kontrollin e territorit me ta dhe për ndalimin e ndërtimeve pa leje, për arsye se ata kanë grupin e policëve, gjë që ne do të na lehtësojë shumë, pasi Gjirokastra ndër vite ka pasur ndërtime pa leje që kanë prishur bukurinë e saj. Ne i kemi evidentuar këto raste dhe jemi në pritje të vendimit që do të merret. Në bazë të ligjit të ri, inspektorati do të merret me kontrollin e këtyre punimeve dhe kjo gjë do të jetë një ndihmë e madhe për ne.

Sfidat tona për të ardhmen janë të kemi investime të konsiderueshme për objektet, të cilat janë në rrënim e sipër, disa të shkatërruara e disa në kolaps. Ekziston një braktisje e madhe e objekteve në Gjirokastrë, ku njerëzit nuk u dalin për zot, as i shesin dhe as nuk i mirëmbajnë. Për këtë duhet vënë dorë, se edhe nëse i rregullojmë tani këto objekte të braktisura, pas 10 vjetësh do të duhet të rregullohen përsëri, pasi në to nuk banojnë njerëz, të cilët mund t'i mirëmbajnë dhe t'i administrojnë. Po shuhen vlera të rëndësishme të Gjirokastrës, është shumë e vështirë të ngrihet një shtëpi, e cila ka rënë, pasi secila shtëpi është një kala e vogël për këtë qytet. Unë mendoj që këtë vit duhet të përqendrohet një fond, ku një pjesë e mire e tij, të mos shkojë për rrugët, por te pjesa e rikonstruktimit të këtyre objekteve.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ledion Lako – Në qytetin e Gjirokastrës ka pasur ndërhyrje shumë të mira restauruese, të cilat vazhdojnë dhe vitin e ardhshëm do të rritet fondi i mirëmbajtjes për sa i përket qytetit të Gjirokastrës. Pra, i gjithë ky fond që rritet është për ndërhyrjet emergjente që kanë objektet në të gjithë qytetin. Besoj se do të ndihmojë për t'i restauruar, që këto monumente të jenë në gjendje të mirë. Histori suksesi janë bujtinat. Është hera parë që ka një numër kaq të madh vizitorësh në kalanë e Gjirokastrës, pra që e kalon 100-mijëshin. Kjo ka ndodhur për shkak të promovimit të madh, të kësaj vëmendje të madhe që qeveria ka treguar për atraksionet dhe vendet turistike. Patjetër që vetë banorët e Gjirokastrës kanë investuar në këto bujtina, të cilat duke u rijetësuar, duke pasur njerëz, edhe mirëmbahen më mirë. Ky është qëllimi ynë afatgjatë. Kjo është politika jonë për të pasur një bashkëpunim shumë të mirë të Ministrisë së Kulturës me qytetarët dhe me

biznesin, ata që janë të interesuar që të krijojnë këto aktivitete të reja. Patjetër që kjo do të na ndihmojë. Drejtoria Rajonale e Kulturës e Gjirokastrës ka një bashkëpunim me qytetarët, duke hartuar projekte, pra u ofrojnë projekte falas atyre që kanë këto bujtina, i miratojnë në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve, pastaj qytetari që do të zhvillojë aktivitetin e tij në këto bujtinë, pra e ka shumë të thjeshtë.

Milva Ekonomi – Sa staf keni?

Vasil Polo – Rreth 30 punonjës. Nga këta 4 janë inxhinierë ose arkitektë, kemi 6 punëtorë dhe pjesa tjetër është administratë.

Jani Duri – Është rajonale. Është parku i Antigonesë që ka 5 punëtorë mirëmbajtjeje, është 1 punëtor mirëmbajtje bashkë me specialistë në Tepelenë, 1 punëtor mirëmbajtje bashkë me specialistë në Përmet dhe 1 punëtor mirëmbajtje në Libohovë. Për qytetin e Gjirokastrës janë vetëm 5 mirëmbajtës...

Fidel Ylli – Po kjo ndarje që brenda një ambienti me dy muze, njëri i përket bashkisë, tjetri i përket drejtorisë rajonale?

Jani Duri – Ju si ligjvënës duhet të kërkonit dy gjëra për qytetin e Gjirokastrës. E para, zgjidhja e çështjes së pronësisë së objekteve. Duhet një ndërhyrje në ligj, e cila të përcaktojë që një objekt me pronësi private të bëhet në formë të tillë që t'i kërkohej atij privatit të bëjë ndërhyrjen për ato objekte të rëndësisë së veçantë dhe, nëse ato dëmtohen, humbasin vlera të veçanta. Në qoftë se privati nuk pranon të bëjë ndërhyrje në objekt, atëherë shteti të bëjë ndërhyrje nëpërmjet investimeve nga Ministria e Kulturës apo nga DRKK-të. Kjo mund t'i kalojë me gjysmë pronësi ose me pronësi të plotë, pra nuk e di se si mund të zgjidhet në ligj kjo.

Ndërhyrja tjetër që duhet zgjidhet me ligj është Muzeu i armëve. Nuk është vetëm Gjirokastra, por janë Shkodra e Berati, të cilat kanë të njëjtin problem. Muzeu i armëve në të gjitha shtetet e vizitueshme kalon në administrim të bashkive.

Fidel Ylli – Cili ka qenë argumenti?

Jani Duri – Është kërkuar vazhdimisht që t'i hiqet bashkisë kjo.

(Diskutime.)

E njëjta gjë ndodh edhe në Shkodër. Muzeu i armëve është në administrim të Bashkisë së Shkodrës.

(Diskutime.)

Bujar Çela – Në të njëjtën godinë?

Jani Duri – Po, në të njëjtën godinë.

(Diskutime.)

Vasil Polo – Rritja e numrit të vizitorëve në kalanë e Gjirokastrës këtë vit nuk ka ardhur vetëm si rezultat i vendosjes së biletarisë elektronike. Në vitin 2013 kemi pasur 9 mijë, në vitin 2014 kemi pasur 50 mijë, në vitin 2015 kemi një ulje në 30 mijë, pastaj kemi gjithmonë ngritje, në vitin 2016 kemi pasur 62 mijë, në vitin 2017 kemi pasur 76 mijë dhe tani, deri në tetor, ishin 110 mijë. Pra, ngritja është bërë graduale dhe e qëndrueshme gjatë gjithë këtyre viteve. Nga mirëmenaxhimi që i është bërë Gjirokastrës, ka pasur një fluks më të madh të turistëve.

Milva Ekonomi – Merita që ka më shumë vizitorë nuk është juaja, por është e promovuesve.

Vasil Polo – Neve na vjen mirë kur na vijnë për herë të dytë dhe për herë të tretë turistë për të parë këtë gjë.

Jani Duri – Merita jonë është menaxhimi.

Vasil Polo – Drejtori i Përgjithshëm ju tha se nuk mund të vijnë vetëm për Gjirokastrën. Gjirokastra para 5 vjetve nuk ka pasur asnjë bujtinë, asnjë hotel për të fjetur. Tani mund të vijnë të rrinë një natë. Vijnë të huaj që rrinë dy-tri net dhe ikin përsëri. Ne për të mirëmbajtur kalanë e Gjirokastrës me ata 5 punëtorë që kemi, bëjmë vërtet punë titanike.

Milva Ekonomi – Keni projekte për ndonjë gjë të re në kala?

Vasil Polo – Po, ne kemi një projekt që ka të bëjë me hyrjen e kalasë së Gjirokastrës. Ne kemi menduar një hyrje më të bukur të kalasë dhe rregullimin e banjave, pra banjat do t'i bëjmë pak më moderne, sepse e kemi projektin për ta bërë këtë gjë në Gjirokastrë.

Fidel Ylli – Te sitet arkeologjike, si Butrinti, që nuk është zbuluar 100% e gjithë historia e zonës, por 40%, a ka ndonjë plan për të gërmuar më shumë, për të parë se çfarë ka më tepër historia e kalasë?

Vasil Polo – Historia e kalasë së Gjirokastrës është vërtet e paeksponuar e gjitha. Ne vjet kishim një problem me disa çarje dhe kanë ardhur disa grupe nga ministria dhe Kryeministria për t'i parë. Një nga fazat është edhe studimi i pjesës së murit që ka pasur çarje; ne duhet të shikojmë edhe pjesën e brendshme të murit. Kjo kërkon vërtet një punë shumë të madhe për t'u ekspozuar, sepse një pjesë e këtyre, që duken sikur janë gërmadha, poshtë tyre ka harqe shumë të bukura. Prandaj, ne duhet të fillojmë të gërmojmë. Faktikisht, ministria na ka thënë se duhet të na ndihmojë për të hapur këtë.

Ledion Lako – Studimet dhe gërmimet i bën Instituti i Arkeologjisë, ne i miratojmë, pra Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, por për sitet, të cilat janë në UNESCO, ka rregulla të qarta për gërmimet në këto qytete, siç është Berati dhe Gjirokastra, por edhe parku i Butrintit.

Vasil Polo - Kurse në sitet e tjera çdo vit vijnë ekspedita të ndryshme, bashkëpunim shqiptaro- italian apo shqiptaro- greke ose edhe nga vende të tjera, të cilat çdo vit gërmojnë dhe nxjerrin, sepse deri tani është zbuluar vetëm 10% dhe vazhdojnë të gërmojnë.

Fadil Nasufi – Nga raporti i monitorimit që bën UNESCO është pozitiv fakti që edhe Gjirokastra ka dalë nga rreziku, por duhet mbështetur për ndërhyrje.

Së dyti, meqenëse Berati dhe Gjirokastra janë në një sit, ka një plan të përbashkët menaxhimi, a ndiqet kjo dinamikë e planit të menaxhimit për të dyja qytetet me evente, me kalendar?

(Diskutime pa mikrofon.)

Qeveria ka një fond të dedikuar, rreth 5 milionë lekë të rinj, që e jep për statusin e UNESCO-s, a ju vjen ky fond 100% këtu, sepse i shkon bashkisë?

Jani Duri – Nuk ka lidhje me ne, ajo kalon në pushtetin vendor.

(Diskutime pa mikrofon.)

Bledar Çuçi – Në Komisionin e Ligjeve e kam ngritur atë problem dhe financa nuk ka dhënë asnjë lek te kolona e veçantë as për Beratin dhe as për Gjirokastrën.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ledion Lako – E ke te transfertat e pakushtëzuar. Unë po them një gjë, që e kam menaxhuar 100%.

Bledar Çuçi – Po të them se nuk është më.

Ledion Lako – Ne kemi bërë disa bashkëpunime me Bashkinë e Gjirokastrës për hartimin e projekteve...

(Diskutime pa mikrofon)

Milva Ekonomi – Të hënën, kur të kemi mbledhje, do ta diskutojmë këtë problematikë.

Bledar Çuçi – Unë e kam ngritur këtë problem në Komisionin e Ligjeve.

Jani Duri – Bashkia në bashkëpunim me ne e ka hartuar dhe zbatuar. Vjet kishte një projekt për Muzeun Etnografik, ku u bë një rikonstrukcion i plotë, çatia dhe një pjesë të fasadës, kurse sivjet ka tri projekte të menaxhimit dhe të rregullimit të rrugëve me kalldrëm në disa pjesë të Gjirokastrës. Ne e kemi hartuar projektin bashkë me bashkinë për këto zëra.

Bujar Çela – Kam një pyetje. Marr shkas nga vërejtje që ka dy pronësi, ne në Lushnjë nuk kemi fare armë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Dua një përgjigje nga zoti Velaj, si e ka bota këtë, Vjena në veçanti?

(Diskutime pa mikrofon)

Ledion Lako – Çdo vendimmarrje që merret në Këshillin Kombëtar të Restaurimeve, që ka të bëjë me këto dy qytete, pra Berat dhe Gjirokastrën, patjetër që ne marrim një opinion edhe nga UNESCO, informojmë dhe presim opinionin e tyre sesi ata vendosin për ndërhyrjet që bëhen dhe që mund të ndikojnë në këtë trashëgimi kulturore.

Ismet Beqiraj – Kam një pyetje, që ju e morët me mend se për çfarë bëhet fjalë. Ju keni kërkuar mbështetjen e komisionit për shkarjet tektonike, sepse, kur ka ndodhur një fenomen i tillë, është diskutuar shumë në komision...

Jani Duri – Vjet, si rezultat i shirave që ka pasur në Gjirokastrë dhe në Jugun e Shqipërisë, u shfaqën shumë probleme në kalanë e Gjirokastrës dhe një nga ato ishin çarjet, që ne nuk i pamë, por te pjesa juglindore ka pasur disa çarje, të cilat janë të para disa viteve. Ne i kemi monitoruar ato çarje dhe kemi filluar me mbrojtjen e tyre dhe nuk ka pasur lëvizje. Vjet ka pasur disa rrëshqitje në periferi. Në vitet ‘70-80 ka pasur disa çarje të mëdha të shkëmbinjve, të cilave u është vendosur beton dhe hekura të lidhura, por ne kemi frikë se mos aktivizohen ato. Ka pasur disa studime nga specialistë italianë, të cilët tregojnë se në një pjesë të Gjirokastrës ka një çarje dhe për këtë u aktivizuam të gjithë, dhe kanë ardhur 4 grupe për të bërë studime për këtë. Ne jemi në pritje të një projekti për menaxhimin e të gjitha këtyre problematikave, sepse Gjirokastra ka probleme tektonike.

Milva Ekonomi- A keni ndonjë kërkesë specifike për ne?

Lidhur me ligjin e ri të trashëgimisë kulturore dhe muzeve, ministria po harton aktet nënligjore. Ndoshta mund të përmirësohet diçka brenda kuadrit ligjor.

Me aktivitetet që bëjmë, ne do ta promovojmë sa më shumë *sajtin* tuaj të trashëgimisë kulturore dhe, ndërkohë, do t’ju këshillojmë, sepse në komision kemi dëgjuar shumë për çarjet dhe që keni thirrur shumë grupe, që edhe ju të bëni presion, në mënyrë që konkluzionet të vijnë sa më shpejt. Instituti i Monumenteve të Kulturës erdhi në komision me një këshillë që leshi i xhamit duhet të hynte në çarje. Ju lutem shumë, ky opinion të bëhet sa më publik, edhe për faktin se si duhet menaxhuar ky dëm.

A ka gjëra të tjera për të shtuar?

Vasil Polo – Kam një propozim, që të ezuarojmë të gjithë pjesën e kalasë, të shkojmë te pjesa e burgut dhe pjesën tjetër ta bëjmë një herë tjetër.

MBYLLET MBLEDHJA